



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 24 shtator 2020
Nr. ref.:RK 1620/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI226/19

Parashtrues

Hysri Peçani

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1191/19, të 8 nëntorit 2019, Urdhëresën [Ppr. Nr.487/2018] e 8 gushtit 2019, të Gjykatës Themelore në Prizren dhe Urdhrin për ndalim afatgjatë të pasurisë [Ppr. nr. 487/2018] të 14 gushtit 2019, të Gjykatës Themelore në Prizren.

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Hysri Peçani, me vendbanim në Komunën e Prizrenit (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [P.nr.1191/19] e 8 nëntorit 2019, të Gjykatës Themelore në Prizren (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
3. Parashtruesi gjithashtu konteston edhe Urdhëresën [Ppr. Nr.487/2018] e 8 gushtit 2019, të Gjykatës Themelore në Prizren dhe Urdhërin për ndalim afatgjatë të pasurisë [Ppr. nr. 487/2018] të 14 gushtit 2019, të Gjykatës Themelore në Prizren.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Akteve të kontestuara, përmes së cilëve pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] e 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 16 dhjetor 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën përmes postës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 20 dhjetor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërzhaliu Krasniqi Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
8. Më 31 dhjetor 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai sqarimin se (i) a përfaqësohet vetëm apo përmes përfaqësuesit; dhe (ii) j të sqarojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar.
9. Më 20 janar 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë plotësimin e kërkesës ku theksoi që nuk ka angazhuar përfaqësues dhe në thelb pretendon se është i diskriminuar si pjesëtar i komunitetit RAE -Ashkali.
10. Më 30 prill 2020, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Themelore.
11. Më 2 shtator 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Nga shkresat e lëndës rezulton që parashtruesi i kërkesës atakon vendime të gjykatave të rregullta për dy raste të ndara, përkatësisht (i) *rasti i parë* lidhur me veprën penale të mashtrimit nga paragrafi 1 i nenit 335 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-082 (Në tekstin në vijim: Kodi Penal), rast i cili ka filluar nga viti 2015, e për të cilin ka vendosur Gjykata Themelore në Prizren përmes Aktgjykimit [P.nr.1191/19] të 8 nëntorit 2019; dhe (ii) *rasti i dytë* për të cilin kanë filluar hetimet në vitin 2018 lidhur me disa vepra penale, përkatësisht Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike nga paragrafi 1 i nenit 262, shmangie nga tatimi nga paragrafi 1 i nenit 313, Mashtrimi nga paragrafi 1 i nenit 335 dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga paragrafi 1 i nenit 374 të Kodit Penal, për të cilat ende nuk ka vendim merititor të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special.

(i) *Rasti i parë lidhur me veprën penale Mashtrimi - Aktgjykimi [P.nr.1191/19] i 8 nëntorit 2019, i Gjykatës Themelore në Prizren*

13. Më 12 mars 2015, Prokuroria Themelore në Prizren paraqiti aktakuzën [PP/II. nr.3188/2014] kundër parashtruesit të kërkesës për shkak të veprës penale të mashtrimit të përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 335 të Kodit Penal.
14. Nga shkresat e lëndës rezulton që Prokuroria Themelore në thelb e akuzonte parashtruesin e kërkesës për veprën penale të mashtrimit, bazuar në dëshmitë e dhëna nga disa të dëmtuar, anëtarë të së njëjtës familje, të cilët e kanë bindur Gjykatën Themelore që parashtruesi i kërkesës u kishte kërkuar dhe marrë shuma të konsiderueshme parash, për shërimin e sëmundjes që nuk i shëron mjekësia bashkëkohore, ndërsa parashtruesi i kërkesës pretendonte se i shëron në bazë të metodave të veçanta të mjekësisë popullore në cilësinë e shëruesit shpirtëror.
15. Më 8 nëntor 2019, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [P.nr.1191/19] të 8 nëntorit 2019, parashtruesin e kërkesës e shpalli: (i) fajtor për kryerjen e veprës penale të mashtrimit të përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 335 (Mashtrimi) të Kodit Penal; (ii) dënoi me gjobë në shumën prej 5000 (pesëmijë) euro; (iii) e dënoi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti; dhe (iv) i shqiptoi edhe dënimin plotësues të ndalimit të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë së pavarur dhe detyrës në kohëzgjatje prej 3 viteve.
16. Aktgjykimi i lartpërmendur, kishte dhënë edhe këshillën juridike që ndaj të njëjtit aktgjykim lejohet ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.
17. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtron ankesë ndaj Aktgjykimit [P.nr.1191/19] të 8 nëntorit 2019, të Gjykatës Themelore dhe ende është në pritje të vendimit nga Gjykata e Apelit.

Rasti i dytë lidhur me veprat penale Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike, shmangie nga tatimi, Mashtrimi dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të

paautorizuar të armëve – (i) Urdhëresa [Ppr. Nr.487/2018] e 8 gushtit 2019, e Gjykatës Themelore në Prizren dhe (ii) Urdhri për ndalim afatgjatë të pasurisë [Ppr. nr. 487/2018] i 14 gushtit 2019, i Gjykatës Themelore në Prizren

18. Më 17 nëntor 2018, Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, filloi hetimet kundër parashtruesit të kërkesës për shkak të dyshimit të arsyeshëm se ka kryer veprën penale Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike nga paragrafi 1 i nenit 262, shmangie nga tatimi nga paragrafi 1 i nenit 313, Mashtrimi nga paragrafi 1 i nenit 335 dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga paragrafi 1 i nenit 374 të Kodit Penal.
19. Më 26 korrik 2019, Prokuroria Themelore në Prizren, zgjeroi hetimet kundër parashtruesit të kërkesës për shkak të veprave penale: Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike nga paragrafi 1 i nenit 256 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074 (në tekstin e mëtejshëm: Kodi i ri Penal) dhe veprës penale Shantazhi nga paragrafi 1 i nenit 341 të Kodit Penal të Kosovës.
20. Në bazë të shkresave të lëndës rezulton që ndaj parashtruesit të kërkesës në kuadër të rastit të dytë, ishin ndërmarrë disa veprime procedurale lidhur me paraburgimin e tij dhe veprime procedurale lidhur me vazhdimin e paraburgimit.
21. Më 27 korrik 2019, sipas kërkesës së Prokurorisë Themelore në Prizren, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [PPpr.nr.487/2018], parashtruesit të kërkesës, i ka caktuar paraburgimin në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve. Gjithashtu, më 22 gusht 2019, Gjykata Themelore me Aktvendimin [PPpr.nr.487/2018] ka vazhduar masën e paraburgimit edhe për dy muaj, i cili zgjati deri me 25 tetor 2019.
22. Më 8 gusht 2019, Gjykata Themelore përmes Urdhëresës [Ppr. Nr.487/2018] bazuar në nenin 112 [Sekuestrimi i përkohshëm] të Kodit Nr. 04/L-123 të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin në vijim: Kodi i Procedurës Penale) urdhëroi sekuestrimin e sendeve dhe dëshmive duke përfshirë edhe një numër të caktuar veturash dhe sende tjera të vlefshme, të cilat do të mbahen në ruajtje në Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar në Prishtinë (AAPSK), deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës. Në fund të kësaj urdhërese jepej edhe Këshilla Juridike, përkatësisht kundërshtimi drejtuar kolegjit (jo) shqyrtues të Gjykatës Themelore, kundër kësaj urdhërese, të cilin e ka shfrytëzuar në afatin e përcaktuar parashtruesi i kërkesës.
23. Më 14 gusht 2019, Gjykata Themelore në Prizren, përmes urdhrit për ndalim afatgjatë të pasurisë [Ppr. nr. 487/2018], bazuar në paragrafët 1, 6, nënparagrafi 6.2, 9, 10 të nenit 266 [Shqyrtimi për konfirmimin e ndalimit të pasurisë] të Kodit Nr. 04/L-123 të Procedurës Penale të Kosovës: (i) ndaloj shitjen dhe tjetërsimin e paluajtshmërive të parashtruesit të kërkesës; (ii) Urdhëroi Agjencinë Kadastrale të Kosovës –Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi e Komunës së Prizrenit si dhe Odën e Noterëve të Kosovës të zbatojnë këtë urdhër; (iii) Pronari i paluajtshmërisë e vazhdon shfrytëzimin e pasurisë së lartcekur por

të njëjtën nuk mund ta shesë apo ta shkëmbejë në ndonjë mënyrë tjetër pronësinë mbi pasurinë; (iv) Kjo urdhëresë nuk skadon deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, pushimit të hetimit ose deri në ngritjen e aktakuzës në të cilën nuk është përfshire paluajtshmëria cekur në aktakuzë; (v) urdhri për ndalim afatgjatë vlen në tërë territorin e Kosovës; (vi) Për këtë urdhër njoftohet Prokurori i shtetit, parashtruesi i kërkesës, mbrojtësi i tij, si dhe personi V.M nga Prizreni, që mund të ketë interes pasuror në këto paluajtshmëri; (vii) Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e urdhrit për ndalim afatgjatë. Në fund të këtij urdhri jepej edhe Këshilla Juridike, përkatësisht ankesa drejtuar Gjykatës së Apelit, kundër këtij urdhri për ndalim afatgjatë të pasurisë, të cilin parashtruesi i kërkesës, sipas deklaramit të tij e ka shfrytëzuar në afatin e përcaktuar.

24. Më 3 tetor 2019, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Prokuroria Speciale), përmes Aktvendimit [PPS.nr. 59/2019], zgjeroi hetimet ndaj parashtruesit të kërkesës në drejtim të veprës penale Shpërlarja e parave nga neni 302 i Kodit të ri Penal lidhur me paragrafët 1, 2, nën paragrafi 2.1 të nenit 32 [Detyrimet shtesë të transaksioneve për pasuritë e paluajtshme] të Ligjit nr. 03/L-196 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit.
25. Më 24 tetor 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti Special përmes Aktvendimit [PPS.nr. 177/2018], vazhdoi masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej tre (3) muajve, e cila mund të zgjaste deri më 25 janar 2020.
26. Më 31 tetor 2019, Gjykata e Apelit – Departamenti Special, duke vendosur në procedurën ankimore, përmes Aktvendimit [PN.1S.nr. 75/2019] e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin e shkallës së parë.
27. Kundër aktvendimeve të lartpërmendura, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, me propozimin e anulimit të aktvendimeve të kundërshtuara dhe parashtruesit t'i ndërpritet masa e paraburgimit, ose kjo masë t'i zëvendësohet me masën e arrestit shtëpiak.
28. Më 13 nëntor 2019, Prokurori i Shtetit i Kosovës, përmes shkresës [KMLP.III.nr.96/2019] propozoi që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e parashtruesit të kërkesës të refuzohet si e pabazuar.
29. Më 18 nëntor 2019, Gjykata Supreme e Kosovës, përmes Aktgjykimit [PML.nr.337/2019], refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës dhe konfirmoi vazhdimin e paraburgimit për parashtruesin e kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

30. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes Akteve të kontestuar, atij i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.
31. Parashtruesi i kërkesës pretendon që ai është dënuar në mungesë të provave. Ai pretendon se është shëruar shpirtëror dhe se biznesi i tij nuk ka të bëjë me

mjekësi farmaceutike. Arrestimi i tij se gjoja është zënë në flagrancë duke punuar, nuk qëndron pasiqë i njëjti e ka të regjistruar biznesin e tij dhe se ka një numër të madh të kërkesave të qytetarëve për tu kontrolluar tek ai.

32. Sipas parashtruesit të kërkesës, përkundër asaj që në Kosovë ka numër të madh të klerikëve fetarë dhe “falltarëve” të cilët ushtrojnë veprimtari të njëjtë ose të ngjashme, d.m.th. japin këshilla, bëjnë lutje dhe veprime të caktuara, si dhe shkruajnë ‘hajmali’, ndaj tyre nuk vlen “ligji i njëjtë”, ndërsa ai ndjehet që ndaj tij është bërë diskriminim racor pasi që i takon komunitetit RAE.
33. Për më tepër, ai pretendon që *sekuestrimit i pasurisë së tij* është i pabazuar, pasi që të njëjtën e ka fituar me punë të ndershme, e njëjta është fituar në një periudhë të gjatë kohore, përmes marrjes së kredive në banka dhe punës së bizneseve tjera që i ka në pronësi. Ai konsideron se tërë veprimet e organeve publike janë të orkestruara me qëllim që “t’ia marrin tërë pasurinë”. Përfundimisht, ai konsideron se ishte korrekt ndaj të gjithë klientëve të tij dhe se posedon fakte të shumta në formë video inçizimesh të nevojshme për shtetin dhe se i njëjti pret të shpërblehet me dekoratë dhe të propozohet për “çmimin Nobel”.
34. Nga shkresat e lëndës vërehet se parashtruesi i kërkesës kishte kontestuar disa vendime rreth vazhdimit të paraburgimit, mirëpo të njëjtat janë referuar vetëm për arsye të reflektimit të rastit, pasi që parashtruesi nuk e ka ngritur si pretendim konkret.
35. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata të vendosë që Aktgjykimi i kontestuar është marrë në shkelje kushtetuese të “*diskriminimit racor*”.

Dispozita relevante Ligjore

Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale

Neni 266

Shqyrtimi për konfirmimin e ndalimit të pasurisë

1. Gjyqtari i procedurës paraprake mund të marrë parasysh provat apo dëshmitarët në mbështetje të urdhrit ndalues të lëshuar më parë gjatë çmuarjes nëse duhet lëshuar urdhër për ndalim afatgjatë në përfundim të shqyrtimit për ndalim. Ai poashtu mbështet urdhrin për ndalim afatgjatë në provat e paraqitura gjatë shqyrtimit për ndalim nga paragrafët 2., 3. dhe 4. të këtij neni.

2. Prokurori i shtetit paraqet prova ose dëshmitarë në mbështetje të urdhrit ndalues.

3. I pandehuri mund të paraqet prova ose dëshmitarë për të kundërshtuar provat në mbështetje të urdhrit ndalues, ose mund të paraqesë argumente kundër bazës ligjore për urdhrin ndalues.

4. Palët tjera që kanë të drejta në pasuri paraqesin prova ose dëshmitarë për të kundërshtuar provat në mbështetje të urdhrit ndalues, ose mund të paraqesin argumente kundër bazës ligjore për urdhrin ndalues.

5. Gjyqtari i procedurës paraprake lëshon urdhër për ndalim afatgjatë për secilin aset që kërkohet nëse ka prova të artikulueshme që tregojnë shkak të bazuar për të arsyetuar urdhrin.

6. Në përfundim të shqyrtimit, gjyqtari i procedurës paraprake lëshon urdhër, me të cilin:

6.1. refuzon ndalimin e pasurisë dhe lëshon urdhër për lirimin e menjëhershëm të pasurisë; ose

6.2. konfirmon ndalimin e pasurisë dhe menjëherë lëshon urdhër për ndalim afatgjatë.

7. Në përfundim të shqyrtimit, gjykata mund të urdhërojë që pasuria të administrohet nga Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar vetëm nëse gjykata është e bindur se me urdhër ndalues nuk do të arrihet të parandalohet që pasuria të mos largohet nga kompetenca territoriale e saj.

8. Përveç mjeteve të mbajtura në llogari financiare të ngrirë apo llogari financiare të ndaluar, i pandehuri ose shfrytëzuesi i pasurisë vazhdon shfrytëzimin e pasurisë por nuk mund ta shesë apo ta shkëmbejë në ndonjë mënyrë tjetër pronësinë mbi pasurinë.

9. Urdhri për ndalim afatgjatë i lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprak në Kosovë vlen për të gjithë territorin e Kosovës.

10. Urdhri për ndalim afatgjatë i lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprake nuk skadon deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, pushimit të hetimit ose sipas paragrafit 11. të këtij neni.

11. Nëse pasuria e përcaktuar në urdhrin për ndalim afatgjatë nuk ceket në aktakuzën nga neni 241 të këtij Kodi, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të vendos për lirimin e pasurisë për të gjitha palët e përfshira në urdhrin për ndalim afatgjatë.

12. Urdhri për ndalim afatgjatë mund të ankimohet në Gjykatën e Apelit brenda dhjetë (10) ditëve nga lëshimi i urdhrit. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e urdhrit për ndalim afatgjatë.

Neni 112

Sekuestrimi i përkohshëm

1. Sendet që përkohësisht mund të sekuestrohen janë sende që mund të jenë prova gjatë një procedure penale, sende ose pasuri që kanë mundësuar kryerjen e veprës penale, ose sende që konsiderohen dobi pasurore e fituar me kryerjen e veprës penale dhe për të cilat ligji parasheh sekuestrimin.

2. Sendet, pasuria, provat apo paratë mund t'i nënshtrohen kufizimit të përkohshëm sipas urdhrit të prokurorit të shtetit që zgjat jo më shumë se pesë ditë nëse zyrtarët e autorizuar të policisë mësojnë për sendin, pasurinë, provat apo paratë e tilla gjatë kontrollit apo arrestit të ligjshëm. Prokurori i shtetit kërkon urdhër të gjykatës nga gjyqtari i procedurës paraprake që është në pajtim me paragrafin 3. të këtij neni.

3. Prokurori i shtetit mund të kërkojë nga gjyqtari i procedurës paraprake që të lëshojë urdhër për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, pasurisë, provave apo parave. Kërkesa e tillë duhet të cek me saktësi sendet, pasurinë, provat apo paratë dhe duhet të përshkruajë si mund të jenë këto sende prova të veprës penale, si këto sende, pasuri apo para mund të mundësojnë kryerjen e veprës penale, ose si këto sende, pasuri apo para përbëjnë dobi pasurore të fituar me vepër penale. Sendet, pasuria, provat apo paratë mund të sekuestrohen përkohësisht vetëm me urdhër të gjykatës.

4. Sendet e sekuestruara përkohësisht fotografohen dhe mbahen në kontejnerët përkatës apo në qeset transparente të plastikës dhe zyrtari i autorizuar i policisë ose prokurori i shtetit mbajnë regjistër të fotografive dhe procesverbal mbi mbikëqyrjen për secilin send apo grup të shkresave.

5. Armët, automjetet, aeroplanët ose sendet tjera të mëdha të cilat janë sekuestruar përkohësisht, fotografohen dhe mbahen në zonat e sigurta përkatëse dhe zyrtari i autorizuar i policisë ose prokurori i shtetit mbajnë regjistër të fotografive dhe procesverbal mbi mbikëqyrjen për secilin send apo grup të shkresave.

6. Ndërtesat apo prona e paluajtshme që sekuestrohet përkohësisht vendosen njoftimet e vëna në atë ndërtesë apo pronë të paluajtshme që njoftojnë qytetarët se prona i është nënshtrohur sekuestrimit të përkohshëm, që hyrja në të nuk është e lejuar dhe që ata që hyjnë pa leje mund t'i nënshtrohen arrestit.

7. Paratë apo monedhat të cilat sekuestrohen përkohësisht fotografohen dhe mbahen në kasafortë dhe zyrtari i autorizuar i policisë ose prokurori i shtetit mbajnë regjistër të fotografive dhe procesverbal mbi mbikëqyrjen për secilin send apo grup të shkresave.

8. Paratë e mbajtura në llogarinë bankare e cila është e sekuestruar përkohësisht do të mbahen në një llogari bankare e cila është nën autoritetin e gjykatës.

9. Sendet dhe pasuria e sekuestruar përkohësisht janë nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e prokurorit të shtetit. Prokurori i shtetit mund t'ia delegojë mbikëqyrjen dhe kontrollin zyrtarit të autorizuar të policisë për sendet dhe pasurinë e sekuestruar përkohësisht nga paragrafët 5., 6. dhe 8. të këtij neni.

10. Kur sendet konfiskohen, duhet të tregohet se ku janë gjetur dhe ato sende duhet të përshkruhen. Nëse është e nevojshme, vërtetohet identiteti i tyre

duhet të sigurohet në ndonjë mënyrë tjetër. Vërtetimi për sekuestrimin duhet të lëshohet për sendet e sekuestruara.

11. Nëse personi apo organi i cili ka nën mbikëqyrje sendin, pasurinë, provat apo paratë që i nënshtrohen urdhrit të gjyqtarit të procedurës paraprake nga ky nen refuzon t'ia dorëzojë sendin, pasurinë, provat apo paratë zyrtarit të autorizuar të policisë që është përgjegjës për ekzekutimin e urdhrit, personi apo organi i tillë mund të gjobitet nga gjyqtari i procedurës paraprake deri në pesëdhjetë përqind (50%) të vlerës së sendit, pasurisë, provave apo parave që janë objekt i kontestit. Personi apo organi ndaj të cilit shqiptohet gjoba e tillë mund të paraqesë ankesë kundër gjobës ose mund të shmangë gjobën duke iu bindur urdhrit të gjyqtarit të procedurës paraprake.

Vlerësimi i Pranueshmërisë së kërkesës

36. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
37. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

38. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar që konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [P.nr.1191/19] e 8 nëntorit 2019, të Gjykatës Themelore.
39. Megjithatë, Gjykata vëren se paragrafi 7 i nenit 113 të Kushtetutës gjithashtu përcakton detyrimin e shterimit të *“të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj”*. Ky detyrim kushtetues është i përcaktuar edhe me paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës. Këto të fundit përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“[...]

2. Individ mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Rregulli 39
[Kriteret e pranueshmërisë]

“1. Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjyimit ose vendimit të kontestuar”.

40. Në këtë aspekt, Gjykata rithekson që paragrafi 7 i nenit 113 të Kushtetutës, paragrafi 2 i nenit 47 të Ligjit dhe pika (b) e paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës, përcaktojnë qartë detyrimin e *"shterjes së mjeteve juridike të përcaktuara me ligj"*, me kusht që një kërkesë të deklarohet e pranueshme dhe të shqyrtohen meritat e saj nga Gjykata.
41. Kriteret e vlerësimit nëse ky detyrim është përmbushur janë të përcaktuara qartë në praktikën e Gjykatës dhe janë mbështetur në praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), në harmoni me të cilën, sipas nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, Gjykata është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
42. Arsyetimi i kërkesës për të shteruar mjetet juridike është që t'u ofrojë autoriteteve përkatëse, para së gjithash gjykatave të rregullta, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Ai bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjete juridike efektive për parandalimin, përkatësisht korrigjimin e shkeljeve të të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të mekanizmit të drejtësisë kushtetuese (Shih ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KI67/19, parashtrues *Hajrije Rina Zhitija Ajeti*, Aktvendim për Papranueshmëri i 30 shtatorit 2019, paragrafi 34; KI09/19, parashtrues *Leutrim Hajdari*, Aktvendim për Papranueshmëri i 16 marsit 2020, paragrafi 36; KI30/17, parashtrues *Muharrem Nuredini*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 gushtit 2017, paragrafi 35;; dhe KI94/14, parashtrues *Sadat Ademi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 dhjetorit 2014, paragrafi 24).
43. Në këtë mënyrë, gjykatave të rregullta u jepet mundësia që të korrigjojnë gabimet e tyre përmes procedurave gjyqësore të rregullta para se rasti të vijë në Gjykatën Kushtetuese. Ky rregull bazohet në supozimin e shprehur në nenin 32 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së, që në legjislacionin vendës ka mjete juridike në dispozicion për t'u shfrytëzuar pranë gjykatave të rregullta në lidhje me shkeljen e pretenduar, pavarësisht nëse dispozitat e KEDNJ-së janë inkorporuar në të drejtën nacionale apo jo (shih, *inter alia*, rastin e GJEDNJ-së *Aksoy kundër Turqisë*, kërkesa nr. 21987/93, Aktgjykim i 18 dhjetorit 1996, paragrafi 51). Ky parim nënkupton se mekanizmi mbrojtës i krijuar nga Gjykata Kushtetuese të jetë subsidiar në raport me sistemin e rregullt gjyqësor që mbron të drejtat e njeriut (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 5493/72, Aktgjykimi i 7 dhjetorit 1976, paragrafi 48).

44. Për më tepër, GJEDNJ ka theksuar se rregullat që përcaktojnë hapat procedural që kërkohet të ndërmerren dhe afatet kohore të cilat duhet të respektohen sa i përket paraqitjes së ankesës janë krijuar për të siguruar administrimin e duhur të drejtësisë dhe pajtueshmërinë, veçanërisht, me parimin e sigurisë juridike (shih rastin e GJEDNJ *Ben Salah Adraqui and Dhaime kundër Spanjës*, kërkesa nr. 45023/98, Vendim i 27 prillit 2000).
45. Gjykata vëren se në rrethanat e *rastit të parë* lidhur me veprën penale Mashtrimi - parashtruesi i kërkesës, pasi ishte njoftuar me përmbajtjen e Aktgjykimit [P.nr.1191/19] të 8 nëntorit 2019, të Gjykatës Themelore, parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, e cila sipas shkresave të lëndës ende është në shqyrtim pranë saj. Rrjedhimisht, rezulton se procedura pranë Gjykatës së Apelit ende nuk ka përfunduar.
46. Sa i përket pretendimeve të *rastit të dytë* lidhur me “sekuestrimin e pasurisë së tij”, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pasi ishte njoftuar me përmbajtjen e (i) Urdhërësës [Ppr. Nr.487/2018] së 8 gushtit 2019 të Gjykatës Themelore dhe (ii) Urdhrit për ndalim afatgjatë të pasurisë [Ppr. nr. 487/2018] të 14 gushtit 2019, sipas deklaramit të tij, ai ka parashtruar kundërshtim dhe ankesë përkatëse. Këto veprime, në bazë të shkresave të lëndës janë ndërmarrë në kuadër të *rastit të dytë* lidhur me veprat penale Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike, shmangie nga tatimi, Mashtrimi dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve; ku ende nuk kemi vendim meritore të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special. Rrjedhimisht rezulton se procedura pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special ende nuk ka përfunduar.
47. Gjykata tashmë ka përcaktuar në praktikën e saj gjyqësore se nëse procedurat janë në zhvillim e sipër tek gjykatat e rregullta, atëherë kërkesat e parashtruesve në Gjykatën Kushtetuese konsiderohen të parakohshme (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës: KI09/19, parashtrues *Leutrim Hajdari*, cituar më lartë, paragrafi 41; KI23/10, parashtruese *Jovica Gadžić*, Aktvendim për Papranueshmëri i 19 shtatorit 2013, paragrafi 47; KI32/11, parashtrues *Lulzim Ramaj*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 prillit 2012, paragrafi 23; KI113/12, parashtrues *Haki Gjocaj*, Aktvendim për Papranueshmëri i 25 janarit 2013, paragrafi 32; KI114/12, parashtrues *Kastriot Hasi*, Aktvendim për Papranueshmëri i 3 prillit 2013, paragrafi 33; KI07/13, parashtrues *Ibish Kastrati*, Aktvendim për Papranueshmëri i 5 korrikut 2013, paragrafët 28-29; KI58/13, parashtrues *Sadik Bislimi*, Aktvendim për papranueshmëri i 25 nëntorit 2013, paragrafi 31; dhe KI102/16, parashtrues *Shefqet Berisha*, Aktvendim për Papranueshmëri i 2 marsit 2017, paragrafi 39).
48. Në rrethanat e rastit konkret, bazuar në parimin e subsidiaritetit, Gjykata është e detyruar që kërkesat e parashtruesit t’i shpallë të papranueshme si të parakohshme, gjegjësisht për arsye se nuk janë shteruar mjetet juridike në rastin e tij.
49. Rrjedhimisht, kërkesa shpallet e papranueshme, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe specifikohet më tej përmes pikës (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 47.2 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 39 (1) (b) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 2 shtator 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtarja raportuese



Selvete Gërxhaliu Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi